



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:247060
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05720600

K.DH.SHK.II.nr.442/24

GJYKATA KOMERCIALE – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit M.Zh. B.I., me numër unik identifikues 810901951 dhe seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Arbër Shala., avokat nga Prishtina, për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm – faturës, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1865/23, të datës 15.01.2024, me datën 22.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1865/23, të datës 15.01.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykat1 Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1865/23, të datës 15.01.2024, në piken I të dispozitivit të aktvendimit e ka pranuar si i bazuar prapësimi i debitorit M.Zh. B.I., me numër unik identifikues 810901951 dhe seli në Prishtinë, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 396/23, i lejuar me datë 17.08.2023, nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, ndërsa në piken II të dispozitivit është detyruar kreditori Komuna e Prishtinës që, në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit, t'ia paguaj debitorit M.Zh. B.I., shumën e përgjithshme prej EUR 156.00 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë Euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit për shkak të cenimit thelbësor të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktik dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktvendimi i atakuar të ndryshohet dhe të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit dhe të refuzohet propozimi i kreditorit.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit - faturës nr. 201912785 e datës 20.12.2022, ka lejuar urdhrin për përmbartim P.nr. 396/23, të datës 17.08.2023, me të cilin është urdhëruar debitori, që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit shumën në lartësi prej EUR 500.00, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin mbi lejimin e përmbartimit, me arsyetim se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk është e pranuar nga ana e debitorit, e njëjta është dorëzuar në kopje të pavërtetuar dhe se nuk është treguar koha e përmbushjes së detyrimit në faturë. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, ashtu që urdhri përmbartimor të anulohet, ndërsa të obligohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shpenzimet në emër të përpilimit të prapësimin në lartësi prej 156.00€.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabazuara, ndërsa ka shtuar se dokumenti përmbartues është nxjerr në procedurë të kundërvajtjes në përputhje me nenin 24.4. të LPP-së, dhe është bërë i përmbartueshëm konform Ligjit për Kundërvajtje. Ndërsa, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1865/23, të datës 15.01.2024 në piken I të dispozitivit të aktvendimit e ka pranuar si i bazuar prapësimi i debitorit M.Zh. B.I., me numër unik identifikues 810901951 dhe seli në Prishtinë, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 396/23, i lejuar me datë 17.08.2023, nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, ndërsa në piken II të dispozitivit është detyruar kreditori Komuna e Prishtinës që, në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimin, t'ia paguaj debitorit M.Zh. B.I., shumën e përgjithshme prej 156.00€ (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë Euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara me nenin 182 par.2 të LPK-së, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse

faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sa i përket pretendimeve për zbatimin e gabuar të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbartimore P.nr.396/23 e ka anuluar në këtë çështje përmbartimore. Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se dokumenti i besueshëm-faturat, në bazë të cilit organi përmbartues ka caktuar përmbartimin, nuk i plotësojnë tiparet e përmbartueshmërisë.

Me Nenin Sipas nenit 29 par.1 Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP) është përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën 3 paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Prandaj në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se fatura nuk është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe e njëjta nuk rezulton të jetë pranuar nga debitori. Ndërsa, në shkresa të lëndës Faqe 3 nga 3 nuk ka ndonjë provë me të cilën dëshmohet se kjo faturë i është dorëzuar debitorit në ndonjë mënyrë të rregullt, dhe si e tillë, fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri paraqet dokument të njëanshëm.

Po, ashtu kjo Gjykate vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, për këtë arsye edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin për arsye se dokumenti i besueshëm – fatura në të cilin përmbartuesi privat ka mbështetur urdhrin përmbartimore nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, po ashtu fatura nuk i është dorëzuar debitorit në mënyrë të rregullt sipas LPP-së. Kjo Gjykatë vlerëson se fakti se debitori, në rastin konkret fatura kontestuese, si dokumente nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, pasi që është lëshuar në mënyrë të një anëshme,

Së këndejmi, Gjykata gjen se urdhri për përmbarim i caktuar nga përmbaruesi privat është lëshuar në bazë të një propozimi për përmbarim i cili nuk i ka plotësuar kushtet që kërkohen me Nenin 38 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE
Dhomat e shkallës së dytë
K.DH.SH.II.nr.442/24, me datë 22.05.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi